

32000L0079

Direktiva e Këshillit 2000/79/KE e 27 nëntorit 2000, për Marrëveshjen Europiane mbi Organizimin e Kohës së Punës të Punëtorëve Të Lëvizshëm në Aviacionin Civil, përgatitur nga Shoqata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE), Federata Europiane e Punëtorëve të Transportit (FEPT), Shoqata Europiane Kabina/Cockpit (SHEK), Shoqata Europiane e Linjave Rajonale (SHELRL) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajrorë (SHNTA) (Tekst kuptimi i te cilit lidhet me ZEE)

Gazeta Zyrtare L 302, 1.12.2000, fq.57-60 Rregullorja e Këshillit 2000/79/KE

Direktiva e Këshillit 2000/79/ e 27 nëntorit 2000, lidhur me Marrëveshjen Europiane mbi Organizimin e Kohës së Punës të Punëtorëve Të Lëvizshëm në Aviacionin Civil, përgatitur nga Shoqata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE), Federata Europiane e Punëtorëve të Transportit (FEPT), Shoqata Europiane Kabina/Cockpit (SHEK), Shoqata Europiane e Linjave Rajonale (SHELRL) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajrorë (SHNTA) (Tekst kuptimi i te cilit lidhet me ZEE)

KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Europian dhe veçanërisht nenin 139, pika 2 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh se:

(1) Drejtuesi dhe fuqia punëtore në përputhje me nenin 139, pika 2 të Traktatit mund të kërkojnë së bashku që marrëveshjet e arritura në nivel Komunitar, të zbatohen nga një vendim i Këshillit me propozim të Komisionit.

(2) Këshilli miratoi Direktivën 93/104/KE (1), lidhur me aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës. Aviacioni Civil, ishte një nga sektorët dhe aktivitetet e përjashtuara nga objekti i Direktivës në fjalë. Parlamenti Europian dhe Këshilli, miratuan Direktivën 2000/34/KE duke ndryshuar Direktivën 93/104/KE, me qëllim trajtimin e sektorëve dhe aktivitetëve të përjashtuara më parë.

(3) Komisioni në përputhje me nenin 138, pika 2 të Traktatit, ka konsultuar drejtuesit dhe fuqinë punëtore mbi drejtimin e mundshëm të veprimit Komunitar për sa i përket sektorëve dhe aktivitetëve që nuk janë të përfshira në Direktivën 93/104/KE.

(4) Komisioni duke gjykuar pas një konsultimi të tillë ku veprimi Komunitar ishte i dëshirueshëm, u konsultua edhe një herë me drejtuesit dhe fuqinë punëtore në nivel Komunitar, mbi thelbin e propozimit të parashikuar në përputhje me nenin 138, pika 3 të Traktatit.

(5) Shoqata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE), Federata Europiane e Punëtorëve të Transportit (FEPT), Shoqata Europiane Kabina/Cockpit (SHEK), Shoqata Europiane e Linjave Rajonale (SHELRL) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajror (SHNTA), kanë informuar Komisionin mbi dëshirën e tyre për të hyrë në negociata në përputhje me nenin 138, pika 4 të Traktatit.

(6) Organizatat e mësipërme përfunduan, më 22 Mars 2000 ,një marrëveshje Evropiane mbi Organizimin e Kohës së Punës dhe të Stafit të Lëvizshëm në Aviacionin Civil.

(7) Kjo Marrëveshje, përmban një kërkesë të përbashkët drejtuar Komisionit për të implementuar Marrëveshjen me anë të një vendimi të Këshillit me propozim të tij, në përputhje me nenin 139, pika 2 të Traktatit.

(8) Kjo Direktivë dhe Marrëveshja, përcaktojnë kërkesat më specifike brenda kuptimit të nenit 14 të Direktivës 93/104/KE, lidhur me organizimin e kohës së punës të stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.

(9) Neni 2, pika 7 i Direktivës 93/104/KE , përcakton punëtorë të lëvizshëm, çdo punëtor i punësuar si anëtar i personelit udhëtues ose fluturues nga ana e një sipërmarrjeje, e cila operon me shërbimet e transportit të pasagjerëve dhe mallrave me anë të linjave tokësore, ajrore ose ujrave të brendshëm.

(10) Instrumenti i duhur për të implementuar Marrëveshjen, është Direktiva sipas kuptimit të nenit 249 të Traktatit.

(11) Duke vështruar natyrën tejet të integruar të sektorit të aviacionit civil dhe kushtet e konkurrencës që mbizotërojnë në këtë fushë, objektivat e kësaj Direktive për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve, nuk mund të arrihen siç duhet nga Shtetet Anëtare dhe veprimi Komunitar në këtë mënyrë është i nevojshëm sipas parimit të ndihmës së

përcaktuar nga neni 5 i Traktatit. Kjo Direktivë realizon ato çka nevojiten për të arritur objektivat.

(12) Lidhur me afatet e përdorura në Marrëveshje të cilat nuk janë përcaktuar specifikisht në dokument, kjo Direktivë u lë Shteteve Anëtare të drejtën të përcaktojnë afate sipas legjislacionit dhe praktikës kombëtare siç është rasti për Direktiva të tjera të politikës sociale, duke përdorur afate/kushte të njëjta me kusht që përcaktimet në fjalë, të pajtohen me Marrëveshjen.

(13) Komisioni ka hartuar propozimin e tij për një Direktivë sipas Komunikatës të 20 Majit 1998 “Adaptimi dhe promovimi i dialogut social në nivel Komunitar”, duke marrë në konsideratë statusin e përfaqësimit të palëve nënshkruese dhe ligjshmërinë e secilës klauzolë të Marrëveshjes. Palët nënshkruese së bashku, kanë një status përfaqësimi të mjaftueshëm për personelin fluturues, të punësuar nga një sipërmarrje e cila operon me shërbimet e transportit të pasagjerëve ose të mallrave, në aviacionin civil.

(14) Komisioni ka hartuar propozimin e tij për një Direktivë në pajtim me nenin 137, pika 2 të Traktatit, i cili parashikon që direktivat në fushën e politikës sociale, “të shmangin imponimin e kufizimeve administrative, financiare dhe ligjore, të cilat do të tkurrnin krijimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme”.

(15) Kjo Direktivë dhe Marrëveshje vendosin standarde minimale. Shtetet Anëtare dhe/ose drejtuesit edhe fuqia punëtore, mund të ruajnë ose paraqesin dispozita më të favorshme.

(16) Zbatimi i kësaj Direktive nuk duhet të shërbejë për të justifikuar ndonjë regres lidhur me situatën e cila tashmë ekziston në çdo Shtet Anëtar.

(17) Komisioni ka informuar Parlamentin European, Komitetin Ekonomik e Social dhe Komitetin e Rajoneve duke ju dërguar tekstin e propozimit të tij ,për një Rregullore që përfshin Marrëveshjen.

(18) Parlamenti European miratoi një rezolutë në kuadër të marrëveshjes së partnerëve social, më 3 Tetor 2000.

(19) Zbatimi i Marrëveshjes, kontribuon në arritjen e objektivave sipas nenit 136 të Traktatit,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË :

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Marrëveshjes Europiane mbi organizimin e kohës së punës të stafit të lëvizshëm në aviacionin civil të arritur, më 22 Mars 2000 ndërmjet organizatave përfaqësuese të drejtuesve dhe fuqisë punëtore në sektorin e aviacionit civil: Shoqata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE), Federata Europiane e Punëtorëve të Transportit (FEPT), Shoqata Europiane Kabina/Cockpit (SHEK), Shoqata Europiane e Linjave Rajonale (SHELRL) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajrorë (SHNTA).

Teksti i Marrëveshjes shfaqet në Shtojcë.

Neni 2

1. Shtetet Anëtare mund të ruajnë ose paraqesin dispozita më të favorshme se ato të përcaktuara në këtë Direktivë .

2. Zbatimi i kësaj Direktive, në asnjë rrethanë nuk përbën bazë të mjaftueshme për të justifikuar një reduktim në nivelin e përgjithshëm të mbrojtjes së punëtorëve në fushat e mbuluara nga kjo Direktivë. Një gjë e tillë realizohet pa çënuar të drejtat e Shteteve Anëtare dhe/ose të drejtuesve dhe fuqisë punëtore, që të përcaktojnë në dritën e rrethanave në ndryshim, masa legislative, rregulluese, ose kontraktuale të ndryshme; nga ato mbizotëruese në momentin e miratimit të kësaj Direktive, me kusht që gjithmonë kërkesat minimale të përcaktuara në këtë Direktivë, të zbatohen.

Neni 3

Shtetet Anëtare sjellin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për t'u pajtuar me këtë Direktivë, jo më vonë se 1 dhjetori 2003, ose të sigurojë që brenda asaj date si afat i fundit, drejtuesit dhe fuqia punëtore të kenë paraqitur masat e nevojshme me marrëveshje. Shtetet Anëtare marrin çdo masë të nevojshme për të mundësuar ato që të jenë në pozitën e garantuesit në çdo kohë të konkluzioneve të imponuara nga ana e kësaj Direktive. Shtetet Anëtare menjëherë njoftojnë Komisionin për këto masa.

Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto masa, ata i referohen kësaj Direktive ose e atashojnë atë në rastet e botimit zyrtar të tyre. Metodot e realizimit të referencës në fjalë përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

Neni 4

Kjo Direktivë hyn në fuqi ditën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 5

Kjo Direktivë i adresohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 27 Nëntor 2000.

Për Këshillin

Presidenti

E. GUIGOU

(1) Gazeta Zyrtare L 307, 13.12.1993, fq. 18. Direktiva e ndryshuar me anë të Rregullores 2000/34/KE (Gazeta Zyrtare L 195, 1.8.2000, fq. 41).

SHTOJCË

Marrëveshja Europiane mbi Organizimin e Kohës së Punës të Stafit të Lëvizshëm në Aviacionin Civil konkluduar nga Shoqata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE), Federata Europiane e Punëtorëve të Transportit (FEPT), Shoqata Europiane Kabina/Cockpit (SHEK), Shoqata Europiane e Linjave Rajonale (SHELRL) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajrorë (SHNTA)

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenet 138 dhe 139, pika 2 të tij,

Duke pasur parasysh faktin se neni 139, pika 2 i Traktatit parashikon që marrëveshjet e arritura në nivel Europian, mund të zbatohen me kërkesë të përbashkët të palëve nënshkruese me anë të një vendimi të Këshillit me propozim të Komisionit,

Duke pasur parasysh faktin se palët nënshkruese në këtë mënyrë paraqesin një kërkesë,

Duke pasur parasysh faktin se palët nënshkruese gjykojnë se dispozitat e kësaj Marrëveshje janë "kërkesa më specifike" brenda kuptimit të nenit 14 të Direktivës së Këshillit 93/104/KE dhe se dispozitat e asaj Direktive nuk duhet të zbatohen,

PALËT NËNSHKRUESE KANË RËNË DAKORT SI MË POSHTË:

PIKA 1

1. Marrëveshja zbatohet për kohën e punës së stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.
2. Marrëveshja përcakton kërkesa më specifike brënda kuptimit të nenit 14 të Direktivës së Këshillit 93/104/KE lidhur me organizimin e kohës së punës të stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.

Pika 2

1. 'kohë pune', nënkupton çdo periudhë gjatë së cilës i punësuar punon në dispozicion të punëdhënësit duke kryer detyrat dhe aktivitetet e tij, në përputhje me ligjet dhe/ose praktikën kombëtare.
2. 'staf i lëvizshëm në aviacionin civil', nënkupton anëtarë të ekuipazhit në një avion civil të punësuar nga një sipërmarrje e krijuar në një Shtet Anëtar.
3. 'koha e fluturimit bllok', nënkupton kohën ndërmjet lëvizjes së parë të të një avioni nga vendi i tij i parkimit, me qëllim ngritjen derisa ai të kthehet për të pushuar në vendin e parkimit të përcaktuar dhe, derisa të gjithë motorat të kenë ndaluar.

Pika 3

1. Stafi i lëvizshëm në aviacionin civil gëzon të drejtën e lejës vjetore të paguar prej katër javësh, të paktën sipas kushteve të dhënies së të drejtës të një leje të tillë të përcaktuar nga legjislacioni dhe/ose praktika kombëtare.
2. Koha minimale e lejës vjetore të paguar nuk mund të zëvendësohet me një ndihmë financiare në vend të saj, me përjashtim të rastit kur marrëdhënies së punësimit i jepet fund.

Pika 4

- 1 (a) Stafi i lëvizshëm në aviacionin civil gëzon të drejtën e kontrollit shëndetësor falas para marrjes së detyrës si dhe më pas, me intervale të rregullta.
- (b) Stafi i lëvizshëm në aviacionin civil, i cili vuan nga problemet shëndetsore që dihen në ka lidhje me faktin se ata punojnë gjithashtu natën, do të transferohen kur të jetë e mundshme në ditë pune të lëvizshme a të palëvizshme në të cilën ata përshtaten.

2. Kontrolli shëndetësor falas i përmëndur në paragrafin 1(a) pajtohet me konfidencialitetin mjeksor.

3. Kontrolli shëndetësor falas i përmëndur në paragrafin 1(a) mund të realizohet brenda sistemit shëndetësor kombëtar.

Pika 5

1. Staf i lëvizshëm në aviacionin civil do të ketë mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë sipas natyrës së punës.

2. Mbrojtja e duhur dhe shërbimet parandaluese ose lehtësuese lidhur me shëndetin dhe sigurinë e stafit të lëvizshëm në aviacionin civil, do të jenë në dispozicion gjatë gjithë kohës.

Pika 6

Masa të nevojshme do të ndërmerren për të siguruar se një punëdhënës, i cili ka për qëllim të organizojë punën sipas një sistemi të caktuar, merr në konsideratë parimin e përgjithshëm të përshtatjes së punës të punëmarrësit.

Pika 7

Të dhënat lidhur me sistemet specifike të punës së punonjësve të lëvizshëm në aviacionin civil, u sigurohen autoriteteve kompetente nëse ato e kërkojnë këtë.

Pika 8

1. Koha e punës duhet të trajtohet pa paragjykime nga çdo legjislacion Komunitar në të ardhmen, mbi fluturimin dhe kufizimet e kohës në detyrë dhe kërkesat për pushim edhe në lidhje me legjislacionin kombëtar mbi këtë çështje. Legjislacioni kombëtar merret në konsideratë në të gjitha çështjet në fjalë.

2. Koha vjetore maksimale e punës duke përfshirë disa elemente të zëvendësimit për caktim me detyrë siç përcaktohet nga ligji në fuqi, përbëhet nga 2000 orë ,nga e cila koha bllok e fluturimit, është e kufizuar në 900 orë.

3. Koha vjetore maksimale e punës shpërndahehet sa më e barabartë dhe praktike gjatë gjithë vitit.

Pika 9

Pa cënuar pikën 3, stafit të lëvizshëm në aviacionin civil, u jepen ditë të lira nga çdo lloj detyre dhe zëvendësimi, të cilat u njotohen para kohe si më poshtë:

(a) të paktën shtatë ditë lokale në çdo muaj kalendarik, të cilat mund të përfshijnë çdo periudhë pushimi të parashikuar me ligj dhe;

(b) të paktën 96 ditë lokale në çdo vit kalendarik të cilat mund të përfshijnë çdo periudhë pushimi të parashikuar me ligj;

Pika 10

Palët rishikojnë dispozitat e mësipërme dy vjet nga mbarimi i periudhës së zbatimit të përcaktuar në Vendimin e Këshillit që i jep fuqi kësaj Marrëveshje.

Bruksel, më 22 Mars 2000

Shoqata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE)

Karl-Heinz Neumeister

Sekretar i Përgjithshëm

Manfred Merz,

Nënryetar i Komitetit të Çështjeve Sociale të SHLAE, Kryetar i Grupit Negociator

Federata Europiane e Punonjësve të Transportit (FEPT)

Brenda O'Brien,

Zv. Sekretar i Përgjithshëm

Betty Lecouturier,

President, Komiteti i Ekuipazhit të Kabinës

Bent Gehlsen,

Anëtar i Grupit Negociator, Komiteti i Ekuipazhit të Kabinës

Shoqata e European e Kabinës/Cockpit (SHEK)

Kapiteni Francesco Gentile

Kryetar

Kapiteni Bill Archer

Zevëndës Kryetar

Giancarlo Crivellaro,

Sekretar i Përgjithshëm

Shoqata Europiane e Linjave Ajrore Rajonale (SHELAR)

Mike Ambrose,

Drejtor i Përgjithshëm

Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajrorë (SHNTA)

Marc Frisque,

Drejtor i Përgjithshëm

Allan Brown

Drejtor, Çështjet Aeropolitike dhe të Industrisë